

SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA

KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI

GSK-KPA-A-178/14

Prishtinë

22 Mars 2016

Në çështjen juridike të:

D.M.

Rruga “Kolasinka” nr. 8

Mitrovicë

Pala ankuese

N/A

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga Sylejman Nuredini si kryetar i kolegjit, Beshir Islami dhe Krassimir Mazgalov anëtarë, duke vendosur me ankesën e paraqitur kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës nr. KPCC/D/A/220/2013 të datës 27 nëntor 2013 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA00746), pas shqyrtimit të mbajtur më 22 Mars 2016, mori këtë:

AKTGJYKIM

1. Ankesa e paraqitur nga D.M. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës nr. KPCC/D/R/223/2013, e datës 27 nëntor 2013, në lidhje me kërkesën e regjistruar në AKP me numër KPA00746 refuzohet si e pabazuar.
2. Vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës nr. KPCC/D/A/220/2013 i datës 27 nëntor 2013, në lidhje me kërkesën e regjistruar në AKP me numër KPA00746, konfirmohet.

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Më 23 prill 2007, D.M. (tani e tutje: paraqitësi i kërkesës) duke vepruar në emër të babait të tij të ndjerë D.M. ka paraqitur kërkesë pranë Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP), me të cilën ka kërkuar të drejtën pronësore mbi pronën me sipërfaqe prej 02.35.00 ha, që gjendet në vendin e quajtur Bukosh, Komuna e Vushtrisë. Paraqitësi i kërkesës ka deklaruar se babai i tij i ndjerë i ka blerë dy ngastra kadastrale (**nuk ka specifikuar numrat e ngastrave**) nga D.M. 30 vjet më parë por kurrë nuk është bërë bartja e të drejtës pronësore në emër të babait të tij.
2. Në kërkesë pretendohet se prona e kërkuar nuk është humbur për shkak të rrethanave që janë të ndërlidhura me konfliktin e armatosur që ndodhi në Kosovë më 1998/99, duke treguar datën 1 qershor 1999 si datën e humbjes.
3. Në mbështetje të kërkesës së tij në AKP ka paraqitur dokumentet në vijim:
 - Certifikatën e vdekjes nr. 203-2/207, të lëshuar nga Zyra për Regjistrim Civil e Komunës së Vushtrisë më 22 shtator 2004, e cila dëshmon se D.M. ka vdekur më 9 shkurt 1982.
 - Certifikatën e lindjes nr. 200-2- 4987/2008-1 në emrin e paraqitësit të kërkesës, të lëshuar nga Zyra për Regjistrim Civil e Kragujevcit.
4. Më 25 prill 2013, AKP-ja ka bërë njoftimin e kërkesës përmes publikimit në Gazetën për Njoftim nr. 11 dhe në Buletinin e Zyrës Pronësore të UNHCR-së. Gazeta dhe lista mbeti te kryetari i fshatit Novolan i cili u pajtua t'ua mundësojë palëve të interesuara qasjen në to.

Ato u publikuan edhe në Komunë dhe në Zyrën Komunale për Kadastër, si dhe në Gjykatën Komunale të Vushtrrisë, në Zyrën Rajonale të AKP-së në Mitrovicë, si dhe në Selinë e UNHCR-së, te Avokati i Popullit, OSBE, APK, DRC dhe Zyra e UNMIK-ut në Mitrovicë Veri.

5. Brenda afatit ligjor prej 30 ditësh, në përputhje me nenin 10.2 të ligjit nr. 03/L-079, asnjë palë nuk ka shfaqur interesim për të marrë pjesë në procedurë në lidhje me pronën e cila është subjekt i kërkesës, prandaj kërkesat janë konsideruar si jo-kontestuese.
6. Ekipi i verifikimit i AKP-së *ex officio* ka gjetur dy certifikata mbi të drejtat pronësore:
 - Certifikatën nr. Ul-70202010-00014, në të cilën renditen pesë ngastra kadastrale në emër të babait të ndjerë të paraqitësit të kërkesës dhe
 - Certifikatën nr. Ul-702020210-00150, në të cilën renditen katër ngastra kadastrale në emër të familjes M.(D., D., M., M., V., V.)
7. Sekretariati Ekzekutiv ka kontaktuar me paraqitësin e kërkesës për të konfirmuar numrat e ngastrave kadastrale për të cilat ka bërë kërkesën. Ky i fundit ka deklaruar se nuk i di numrat por vetëm sipërfaqen e pronës e cila sipas tij është 02.35.00 ha (shih faqe nr. 030 të shkresave të lëndës).

Përveç kësaj, Sekretariati Ekzekutiv i AKP-së i ka dorëzuar paraqitësit të kërkesës një letër informacioni me të cilën nga ai është kërkuar të dorëzojë dokumentacion shtesë në mbështetje të kërkesës së tij dhe ku është njoftuar se nëse nuk arrin të dorëzojë dokumentacionin e kërkuar brenda 15 ditësh komisioni mund ta refuzojë kërkesën. Paraqitësi i kërkesës e ka pranuar letrën më 2 shtator 2013 (shih faqe nr. 178 të shkresave të lëndës) por nuk është përgjigjur.
8. Më 27 nëntor 2013, komisioni me vendimin e vet KPCC/D/A/220/2013 ka refuzuar kërkesën me arsyetimin se paraqitësi i kërkesës nuk ka arritur ta dëshmojë pronësinë apo ndonjë të drejtë tjetër pronësore mbi pronën e kërkuar menjëherë para apo gjatë konfliktit të vitit 1998-1999.
9. Vendimi i KKPK-së i është dorëzuar paraqitësit të kërkesës më 7 prill 2014.
10. Më 6 maj 2014, paraqitësi i kërkesës (tani e tutje: pala ankuese) ka paraqitur ankesë në Gjykatë Supreme.

Pretendimet e palës ankuese

11. Pala ankuese e kundërshton vendimi e KKKP-së me pretendim se e ka blerë ngastrën nr. 539 dhe ngastrën nr. 220 nga B.M. dhe M.M. më 1981 dhe se deri në vitin 1999 i kishte në posedim ngastrat e lartpërmendura. Pala ankuese shton se nuk e ka bërë bartjen e të drejtës pronësore në emrin e tij sepse sipas tij në kohën kur i kishte blerë ngastrat e lartpërmendura “fjala e dhënë respektohej shumë” dhe vetëm nëse kishte ndonjë kontest atëherë palët i referoheshin institucioneve përkatëse.
12. Në mbështetje të ankesës së tij ai ka paraqitur dokumentet në vijim:
- Listën poseduese nr. 150 të lëshuar nga Departamenti për Kadastër, Gjeodezi dhe Prona i Komunës së Prishtinës më 5 maj 2014 me familjen M. (B., D., D., M., M., V., Z.) si bashkëpronarë.
 - Listën poseduese nr. 149 të lëshuar nga Departamenti për Kadastër, Gjeodezi dhe Prona i Komunës së Vushtrrisë më 19 janar 1973 me M.M.-in si pronar.

Arsyetimi ligjor

Pranueshmëria e ankesës

13. Ankesa është paraqitur brenda afatit ligjor prej 30 ditësh siç përcaktohet me Ligjin nr. 03/L-079, nenin 12.1 dhe është e pranueshme.

Meritat e ankesës

14. Gjykata Supreme e Kosovës shqyrtoi ankesën në përputhje me dispozitat e nenit 194 të LPK, dhe pas vlerësimit të pretendimeve në ankesë konstatoi se ankesa është e pabazuar.
15. Duke u bazuar në shkresat e lëndës, pala ankuese ka paraqitur kërkesën në emër të babait të tij të ndjerë si bartës i së drejtës pronësore para shkallës së parë kurse në ankesën e tij vetes i referohet si pronar i pronës.
16. Mirëpo, pala ankuese nuk ka mundur të dëshmojë se ai apo babai i tij ishin bartës të së drejtës pronësore.

17. Përveç sipërfaqes së pronës pala ankuese nuk ka dhënë numrat e ngastrave kadastrale për të cilat ka kërkuar, e as nuk ka dorëzuar asnjë dëshmi në mbështetje të kërkesës së tij edhe pse Sekretariati Ekzekutiv e ka këshilluar ta bëjë në gjë të tillë.
18. Në ankesë pala ankuese deklaroi se ka blerë pronat nga pala e tretë, duke i dhënë numrat e ngastrave kadastrale në mbështetje të listës poseduese në emër të palëve të treta.
19. Megjithatë, gjykata nuk i ka shqyrtuar provat e reja. Në bazë të nenit 12.11 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, *faktet e reja dhe dëshmitë materiale të paraqitura nga cilado palë lidhur me ankesën nuk pranohen dhe nuk shqyrtohen nga Gjykata Supreme përpos nëse tregohet se faktet dhe dëshmitë e tilla me arsye nuk kanë mundur të jenë të njohura për palën në fjalë*. Sekretariati Ekzekutiv i AKP-së e ka kontaktuar palën ankuese si dhe zyrtarisht ka këshilluar t'i paraqesë provat po nuk ka arritur ta bëjë këtë (paragrafi 7 i aktgjykimit e shtyn gjykatën të arrijë në përfundim se pala ankuese ka mundur t'i përdorë këto prova më herët në procedurë të KKKP-së.
20. Megjithatë, edhe nëse gjykata do t'i shqyrtonte provat e paraqitura, rezultati në fund do të ishte i njëjtë, sepse vetë pala ankuese ka konfirmuar se nuk e ka bartur pronën në emrin e tij me arsyetimin se në vitin 1981 fjala e dhënë është respektuar shumë.
21. Sipas nenit 4, paragrafëve 2 dhe 3, të Ligjit mbi transferimin e pronës së paluajtshme (Gazeta Zyrtare e Republikës së Serbisë nr. 43/81), ligj i cili ishte zbatuar me rastin e blerjes së pretenduar më 1981, kontrata mbi bartjen e të drejtës mbi pronën e paluajtshme në mes bartësve të së drejtës pronësore **duhet të lidhet me shkrim**; nënshkrimet e palëve kontraktuese të certifikohen nga gjykatat, dhe kontratat të cilat nuk janë në pajtim me këtë as nuk prodhojnë detyrime ligjore e as nuk kanë asnjë efekt real.
22. Gjykata Supreme arrin në përfundim se KKKP-ja ka marrë vendim të drejtë, duke u bazuar në procedurë të drejtë. Prandaj, Gjykata Supreme konstaton se ankesa është e pabazuar.
23. Në bazë të asaj që u tha më lart dhe në bazë të nenit 13.3 (c) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, Gjykata Supreme ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këshillë juridike

24. Në pajtim me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, ky aktgjykim është i formës së prerë dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

Sylejman Nuredini, kryetar i kolegjit

Krassimir Mazgalov, gjyqtar i EULEX-it

Beshir Islami, gjyqtar

Sandra Gudaityte, referente e EULEX-it